



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS
AGJENCIA KOMBËTARE E PROVIMEVE

PROVIMI I MATURËS SHTETËRORE 2011

I DETYRUAR

SKEMA E VLERËSIMIT TË TESTIT

VARIANTI **A**

Lënda: Letërsi dhe Gjuhë shqipe

Shkolla e mesme teknike profesionale (3+2) dhe 5-vjeçare

Udhëzime të përgjithshme:

- Testi përbëhet nga dy pjesë.
- Testi përmban një total prej 50 pikësh.
- Testi ka 25 pyetje. 13 me zgjedhje dhe 12 me zhvillim.
- Për pyetjet me zgjedhje përgjigja e saktë vlerësohet me 1 pikë.
- Për pyetjet me zhvillim përgjigjet konsiderohen orientuese dhe në skemë parashikohen variantet e mundësive të përgjigjeve të nxënësve.
- Vlerësimi i pyetjes **ese** do të bëhet duke pasur parasysh rubrikat në tabelën e vendosur në fund të pyetjes dhe që është posaçërisht për vlerësuesit e testit.
- Saktësia gjuhësore ndikon negativisht në vlerësimin e nxënësit, në ato raste, kur ka përsëritje të theksuar gabimesh ose gabime të cilat prishin në mënyrë të vazhdueshme kuptimin e shprehjes.

PJESA I

Gjergj Fishta

Shqypnija

Pyetja 1	D	1 pikë
Pyetja 2	C	1 pikë
Pyetja 3	B	1 pikë
Pyetja 4	D	1 pikë
Pyetja 5	A	1 pikë
Pyetja 6	B	1 pikë
Pyetja 7	A	1 pikë

Pyetja 8 3 pikë

Model përgjigjeje

Varianti letrar:

** Qofsh – rrufe - të bleruara*

3 pikë	Nëse nxënësi shkruan tri fjalët në variantin letrar (ose gjuhën standarde).
2 pikë	Nëse nxënësi shkruan dy fjalë në këtë variant.
1 pikë	Nëse nxënësi shkruan një fjalë në këtë variant.
0 pikë	Nëse përgjigjja e dhënë nuk i përmbahet pyetjes ose nuk ka përgjigje.

Pyetja 9 2 pikë

Model përgjigjeje

Vargjet që përsëriten janë:

a) Edhe hana do ta dije,
dhe dielli do t'ket pa,
se për qark ksaj rrokullije
si Shqipnija 'i vend nuk ka!

b) *Kjo përsëritje forcon idenë e autorit dhe mesazhin që ai kërkon të përcjellë. Përsëritja e tyre i jep poezisë së Fishtës ritëm, muzikalitet. etj.*

2 pikë	Nëse nxënësi gjen vargjet dhe shpjegon efektin e përsëritjes.
1 pikë	Nëse nxënësi jep vetëm njërin nga dy përgjigjet.
0 pikë	Nëse nxënësi përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Shënim:

Nxënësi do të marrë pikë për kërkesën b), në çdo rast kur përgjigja e tij i afrohet përgjigjes së skemës dhe që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 10 3 pikë

Model përgjigjeje

a) **Ideja e përsosjes morale** del nëpërmjet përshkrimit të djemve dhe dhënies së modelit të trimave shqiptarë.

Kjo përgjigje mund të jepet direkt, por edhe me vargje të shkëputura nga poezia ku përshkruhen djemtë dhe trimat e Shqipërisë.

P.sh.

lejn mande' ata djelm si zana,
armët e t'cilvet, p'rherë besnike,
janë përmendë ndër fise t'tana.

Ose

Përse djelmt, qi ti ke ushqye,
s'i ka pa, jo, kush tue hikun:
Friga e dekës kurr s'i ka thye. etj

b) **Ideja e përsosjes fizike** jepet nëpërmjet përshkrimit të bukurive dhe mrekullisë që të fal natyra shqiptare.

Kjo përgjigje mund të jepet edhe me vargje të shkëputura nga poezia ku përshkruhen bukuritë natyrore të Shqipërisë.

P.sh:

se për qark ksaj rrokullije,
si Shqypnija 'i vend nuk ka!

Ose

Fusha t'gjana e kodra t'blerta,
zijos s'mnershme larg ku asht droja,
me gaz t'vet ktu i vesh prendvera,
si t'Parrizit t'larmet shtroja.

Ose

Ke ato bjeshkë e ke ato male
kroje t'kjarta e t'cemta gurra, etj.

c- Fishta, duke përshkruar malet dhe fushat, të kujton poetin tonë kombëtar, Naim Frashëri dhe poemën e tij “*Bagëti e Bujqësi*”.

- | | |
|---------------|---|
| 3 pikë | Nëse nxënësi jep tri përgjigje si më lart. |
| 2 pikë | Nëse nxënësi jep dy nga përgjigjet si më lart. |
| 1 pikë | Nëse nxënësi jep vetëm një nga përgjigjet si më lart. |
| 0 pikë | Nëse nxënësi jep gabim ose nuk jep përgjigje fare. |

Shënim:

Nxënësi do të marrë pikë të plota ose të pjesshme, në çdo rast kur përgjigja e tij i afrohet logjikës së modelit të përgjigjes së dhënë në skemë, pavarësisht shembullit të zgjedhur nga ai apo shpjegimit individual të përgjigjes.

Pyetja 11 3 pikë

Model përgjigjeje

a) Poezia është shkruar me **varg 8- rrokësh**.

b) Në këtë poezi mbizotëron rima **ABAB**,

c) Fishta ka marrë nga poezia popullore: **rimën, llojin e vargut**, nga Eposi figurën e **Zanës**, që këtu e jep nëpërmjet krahasimit, **konceptin e përsosjes** (kur e quan Shqipërinë dhe natyrën e saj si parajsë), figurat letrare sidomos **krahasimet similitudat dhe epitetet**, etj.

3 pikë Nëse nxënësi jep tri përgjigje referuar skemës më lart.

2 pikë Nëse nxënësi shkruan vetëm dy nga përgjigjet a) b) c).

1 pikë Nëse nxënësi shkruan vetëm një nga përgjigjet a) b) c).

0 pikë Nëse nxënësi përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Shënim: Për pikën c).

Nxënësi do të marrë pikë në çdo rast kur përgjigja e tij i afrohet logjikës së modelit të përgjigjes së dhënë në skemë, pavarësisht shembullit të zgjedhur nga ai apo shpjegimit individual të përgjigjes.

Pyetja 12 4 pikë

Model përgjigjeje

Kultet më të dukshme që ndeshen në letërsinë romantike dhe që gjenden të realizuara në këtë poezi të Fishtës, janë:

a) kulti i **atdheut**

b) kulti i **natyrës**

c) kulti i **heroit, i trimit**.

d)

- Në këtë poezi Fishta shfaq **natyrë romantike**, e cila duket së pari në trajtimin e **temës së madhe të atdheut**.
- Atdheu **idealizohet dhe himnizohet**.
- Kultet e mësipërme alternohen në funksion të kësaj teme të madhe. E rëndësishme për poetin është të përcjellë mesazhin: *Si Shqipnija 'i vend nuk ka!*
- Të gjitha këto jepen me nota të **buta, lirike, nëpërmjet krahasimit, karakterizimit, adhurimit, përsojes, etj.**
- Heroi shihet si **model** dhe i shërben **optimizmit**.
- Konceptet etike (**moralit**) dhe estetike (**e bukura**) përdoren si shembull për të ilustruar idenë e autorit, etj.

4 pikë Nëse nxënësi jep katër përgjigje referuar skemës më lart.

3 pikë Nëse nxënësi jep vetëm tri nga përgjigjet më lart.

2 pikë Nëse nxënësi jep vetëm dy nga përgjigjet më lart.

1 pikë Nëse nxënësi jep vetëm një nga përgjigjet më lart.

0 pikë Nëse nxënësi përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Shënim:

Nxënësi do të marrë pikë të plota ose të pjesshme në çdo rast kur përgjigja e tij i afrohet logjikës së pyetjes dhe modelit të përgjigjes së dhënë në skemë, pavarësisht shembullit të zgjedhur nga ai apo shpjegimit e formulimit individual të përgjigjes.

PJESA II

Alber Kamy

I Huaji (fragment)

Pyetja 13	B	1 pikë
Pyetja 14	A	1 pikë
Pyetja 15	D	1 pikë
Pyetja 16	C	1 pikë
Pyetja 17	A	1 pikë
Pyetja 18	C	1 pikë

Pyetja 19 1 pikë

Model përgjigjeje

Mersoi ndodhet në sallën e gjyqit, sepse **ka kryer një vrasje** dhe pret të **gjykohet** për këtë, etj.

- 1 pikë** Nëse nxënësi jep arsyen pse Mersoi ndodhet në sallën e gjyqit.
0 pikë Nëse nxënësi përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Shënim:

Nxënësi do të marrë pikën edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep arsyen e mësipërme të formuluar në një mënyrë tjetër.

Pyetja 20 2 pikë

Model përgjigjeje

a) Mersoi konsiderohet si personazh **indiferent ndaj botës dhe ndaj fatit të tij**.

Në këtë kënvështrim justifikohet edhe mosreagimi i tij. Shkak i mosreagimit është edhe fakti se atij i duket e kotë **përpyjekja**. Ai mendon se gjithçka tashmë ka marrë fund.

Mersoi gjykohet për atë që është dhe jo për atë që bën, prandaj ai nuk reagon.

Megjithëse zhvillohet gjyqi, opinionet e atyre që gjykojnë Mersoin bëhen të ditura që më parë. Ata **pothuajse e kanë marrë vendimin për të, paraprakisht**.

Dhe kjo është **një situatë absurde**. I ndodhur përballë këtij fakti Mersoit i duket e kotë të **reagojë**.

b) Model **shembulli** nga fragmenti: **Nuk mendoja më për asgjë. Por kryetari më pyeti nëse kisha gjë për të shtuar. U mendova. Thashë: “jo”. Atëherë më morën.**

Shembulli mund të jepet edhe me perifraksim. P.sh: Mosreagimi i Mersoit duket kur atë e marrin pas dhënies së vendimit dhe ai nuk thotë asnjë fjalë.

- 2 pikë** Nëse nxënësi përgjigjet për dy kërkesat si në modelet e përgjigjeve.
1 pikë Nëse nxënësi përgjigjet vetëm për një nga kërkesat.
0 pikë Nëse nxënësi përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Shënim:

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim apo shembull që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por afron me logjikën e pyetjes dhe që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 21 3 pikë

Model përgjigjeje

a)

* Reagimi i parë i Mersoit:

Merso i e kërkon me sy Marian në sallë.

ose

Përgjigja mund të jepet duke dhënë shembullin direkt të shkëptur nga fragmenti: *Kjo më bëri të kujtohem se gjatë gjithë procesit nuk e kisha kërkuar me sy Marian*

* Reagimi i dytë i Mersoit:

Nuk dëshiron të shohë më askënd, as Marian.

ose

Përgjigja mund të jepet duke dhënë shembullin direkt nga teksti: *Nuk vështrova nga Maria.*

b) Merso i ndihet tashmë pa shpresë, krejt i vetmuar apo totalisht i huaj për botën dhe me botën, etj.

3 pikë Nëse nxënësi zbulon dy reagimet dhe jep gjendjen shpirtërore të Mersoit.

2 pikë Nëse nxënësi zbulon vetëm dy reagimet ose një reagim dhe gjendjen shpirtërore të Mersoit.

1 pikë Nëse nxënësi zbulon vetëm njërin reagim ose jep vetëm gjendjen shpirtërore të Mersoit.

0 pikë Nëse nxënësi përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Shënim:

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë jep një shpjegim apo shembull që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por afron me logjikën e pyetjes dhe që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë

Pyetja 22 3 pikë

Model përgjigjeje

a) Përemri **Ne** përfshin: Mersoin, Marian, miqtë e tij Çeleste dhe Rajmond, avokatin, gazetarin i ri, kryetarin, xhandarët, sallën, etj.

b) Të gjithë **presin me padurim** vendimin. Njerëzit i kanë sytë nga Merso i. Ata janë njerëzit e njohur të tij, por edhe të tjerë që nuk e dinë kush është ai. Vetë Merso i shikon të gjithë me radhë për të gjetur midis tyre **një opinion** apo një përgjigje nga reagimi i tyre se si mund të jetë vendimi.

c) Jemi në momentin e vendimit. **Ka ankth, padurim**. Kështu që njëra palë përkrah Mersonë **dhe është me të**, pala tjetër **pret gjakftohhtë, por plot kureshtje vendimin**, përsëri duke parë Mersoin, për të parë reagimin e tij në momentin e **këtij** vendimit.

3 pikë Nëse nxënësi jep tri përgjigje në përshtatje me referimet e mësipërme.

- 2 pikë** Nëse nxënësi jep dy nga përgjigjet në përshtatje me referimet e mësipërme.
1 pikë Nëse nxënësi jep vetëm një përgjigje nga përgjigjet e mësipërme.
0 pikë Nëse nxënësi përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Shënim:

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, bën një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që ka lidhje me logjikën e pyetjes dhe që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë

Pyetja 23 2 pikë**Model përgjigjeje**

a) *Nënteksti është i lidhur me **veprimin që rrjedh shpejt** dhe me faktin që vendimi **është marrë me kohë**, pavarësisht se sa fajtor është Mersoi dhe pa përfillur mbrojtjen e tij etj.*

b) Kjo tregon se personazhi ndodhet ***në një situatë absurde*** etj.

- 2 pikë** Nëse nxënësi jep dy përgjigje sipas modelit të përgjigjeve të mësipërme
1 pikë Nëse nxënësi jep vetëm njërin nga përgjigjet.
0 pikë Nëse nxënësi përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Shënim:

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, bën një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që ka lidhje me logjikën e pyetjes dhe që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë

Pyetja 24 3 pikë**Model përgjigjeje**

a) shenjat që shërbejnë si paralajmërim për vendimin tragjik në paragrafin e fundit mund të jenë:
zilha, përplasja e derës, lëvizja e njerëzve etj.

Përgjigja mund të jepet edhe me shembuj nga paragrafi i fundit:

Më në fund tringëlliu një zile./ U përplasën dyer./ Njerëz vraponin nëpër shkallë etj

b) Një nga tiparet e stilit që del në shprehjen e kërkuar është ***konciziteti***.

I kursyer në fjalë, me një ***thjeshtësi*** të habitshme, me një ***stil të zhveshur***, Kamy jep rrugën drej zgjidhjes së fabulës së tij.

- 3 pikë** Nëse nxënësi jep dy shembujt dhe tiparin e stilit.
2 pikë Nëse nxënësi jep një shembull dhe tiparin e stilit ose vetëm dy shembujt.
1 pikë Nëse nxënësi jep vetëm njërin shembull ose vetëm tiparin e stilit.
0 pikë Nëse nxënësi përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Shënim:

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep shembull dhe bën një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që ka lidhje me logjikën e pyetjes dhe që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë

Pyetja 25

8 pikë

Për esenë do të ndiqen kriteret e mëposhtme:

KRITERI I: SHTJELLIMI I IDESË

2 pikë

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- përshkruan vetminë njerëzore, individuale ose kolektive apo në marrëdhënie të ndërsjellta.
- shpreh pasojat e kësaj vetmie.
- vendos raporte midis vetmisë dhe përballjes së njeriut me të.
- i referohet gjendjes së Mersoit dhe veprës së Kamysë.
- përdor detaje përshkruese.
- përdor figura letrare.
- realizon një përshkrim që ka ritëm dhe larmi këndvështrimesh
- etj.

KRITERI II: ORGANIZIMI DHE STRUKTURA E ESESË 2 pikë

1 pikë Struktura e esesë

- respekton elementet e strukturës së esesë:
hyrjen
zhvillimin
përfundimin

Nxënësi merr **1 pikë** nëse përgjigjen e dhënë e strukturon sipas skemës së mësipërme.

1 pikë Organizimi i esesë

- organizim logjik, ku shfrytëzohen teknika të tilla si koherenca dhe unifikimi i paragrafëve (lidhja logjike mes paragrafëve, kalimi në mënyrë të natyrshme).

KRITERI III: STILI DHE ORIGJINALITETI

2 pikë

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- përmes gjuhës që përdor, krijon një përshtypje të përgjithshme për atë që do të shprehë.
- shprehet me një gjuhë eseistike.
- ka fjalor të pasur.
- stil origjinal.

KRITERI IV: SAKTËSIA GJUHËSORE

2 pikë

(1 pikë sintaksa dhe 1 pikë drejtshkrimi)

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- strukturon qartë përgjigjen nga pikëpamja gramatikore.
- ndërton fjali që janë të sakta dhe të qarta.
- përdor fjali që variojnë në modele, gjatësi dhe ritëm.
- ka saktësi drejtshkrimore.